



Bazuar në dispozitat 38.3 dhe 38.4 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall:

KONKURS
për
Zëvendësguvernator/e
për Operacione Bankare

Zëvendësguvernatori/ja për Operacione Bankare është pozitë e lartë ekzekutive (mbi nivelin e drejtorëve të departamenteve). Zëvendësguvernatori/ja shërben si anëtar/e i/e Bordit Ekzekutiv dhe e ndihmon Guvernatorin në realizimin e operacioneve të BQK-së. Është i/e ngarkuar me funksionet e BQK-së për menaxhimin e mjeteve, furnizimin me para të gatshme, punët bankare për klientë, sistemet e pagesave, dhe funksione tjera. Po ashtu mund të ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi shtesë ose portofol tjetër sipas strukturës organizative.

Profili i kërkuar i kandidatit:

- Të jetë shtetas/e i/e Kosovës;
- Të jetë me integritet;
- Të ketë përgatitje universitare në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të lidhura me objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Përvoja dhe aftësia menaxheriale relevante paraqet përparësi;
- Përvoja profesionale dhe menaxheriale në operacione bankare paraqet përparësi;
- Përvoja në pozita drejtuese në institucione bankare paraqet përparësi;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Dokumentet e kërkuara për pozitën në fjalë:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim (formularin mund ta shkarkoni përmes ueb-faqes: www.bqk-kos.org);
- CV;
- Letër motivuese (ndërlidhni përvojën, kualifikimin me pozitën e synuar);
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e ID-së;
- Kopjet e diplomave (të noterizuara), ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/nostrifikuara zyrtarisht nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Certifikatën nga Gjykata kompetente, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i ndonjë vepre penale (certifikatë kjo jo më e vjetër se 3 muaj); dhe
- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se kandidati/ja nuk është nën hetime (vërtetim ky jo më i vjetër se 3 muaj).
- Certifikatat profesionale, rekomandimet dhe referencat relevante (opsionale).

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të lartcekur në e-mail adresën elektronike paneli@bqk-kos.org, duke e vendosur si titull (subjekt): **Aplikimi për Z.G. për Operacione Bankare**
Afati i fundit për aplikim është 15 shtator 2023.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e panelit do të ftohen për intervistë.